

KMSHC raporton në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), raportoi në Komisionin Parlamentar për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale mbi përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë dhe veprimtarinë e institucionit për vitin 2025.



Gjatë seancës dëgjimore, Komisionerja prezantoi progresin e arritur nga Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, rritjen e inspektimeve, ndërsa theksoi edhe prioritetet e institucionit në drejtim të digjitalizimit të proceseve të mbikëqyrjes dhe përmirësimit të efektivitetit të administrimit të shërbimit civil.



Komisioni vijoi më pas diskutimet mbi projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2025”, duke evidentuar arritjet e institucionit, përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Kuvendi, të orientuara kryesisht në çështje që lidhen me administrimin e shërbimit civil.

